

## MA-905 MATILIGHT

Ngjitës pllakash me bazë çimentoje, ultra elastik, i lehtësuar, i modifikuar me polimer, me forcë të lartë ngjitëse, kohë hapje të zgjatur dhe pa rrëshqitje vertikale, me Fibre Strength Tech dhe Superlite Tech.



**PAKETIMI**  
15kg



**RAPORTI I  
PËRZIERJES**  
6-6.5L/25kg



**KONSUMI**  
1-3 kg/m<sup>2</sup>

### Përshkrimi

MA-905 MATILIGHT është një Ngjitës pllakash me bazë çimentoje, ultra elastik, i lehtësuar, i modifikuar me polimer, me forcë të lartë ngjitëse, kohë hapje të zgjatur dhe pa rrëshqitje vertikale, me Fibre Strength Tech dhe Superlite Tech. Për shkak të lehtësisë së tij, montimi i pllakave bëhet shumë më i lehtë dhe sasia e kërkuar është e zvogëluar krahasuar me një ngjitës me agregate të rregullta. Ofron forcë të lartë ngjitëse fillestare dhe përfundimtare, si dhe qëndrueshmëri ndaj lagështirës.

### Fusha e Përdorimit

- Përdoret për ngjitjen e pllakave të brendshme të dyshemesë qeramike dhe porcelan në një sërë nënshtratesh si betoni, suva, etj.
- Përdoret për ngjitjen e pllakave të granitit, gurëve natyralë dhe tullave dekorative në nënshtrata të ndryshme si betoni, suva, etj., në ambiente të brendshme dhe të jashtme.
- Përdoret për dysheme me ngrohje.

### Përgatitja e Sipërfaqes

Sipërfaqja që do të mbulohet me pllaka duhet të jetë pa pluhur, yndyrë, bojë, etj. Rekomandohet ta lagni sipërfaqen para aplikimit. Përdorni riparuesin MATIART në rastin e nënshtrësve të pabarabarta, për të marrë një sipërfaqe të sheshtë. Nëse është pluhurosur, fshini pjesën e pasme të pllakave me ujë.

### Aplikimi

MA-905 MATILIGHT shtohet ngadalë në ujë duke e përzier vazhdimisht, derisa të formohet një pastë homogjene. Rekomandohet përdorimi i një mikseri me shpejtësi të ulët për përzierjen. Përzierja duhet të lihet të pushojë për rreth 5-10 minuta para se të përziehet përsëri për pak. Për të siguruar ngjitje të mirë, shpërndani llaçin mbi sipërfaqe me anën e shpatullës të sheshtë dhe dhëmbëzoni me anën e dhëmbëzuar. Madhësitë e dhëmbëve duhet të jenë të përshtatshme për përmasat e pllakave. Instaloni pllakat mbi llaçin e dhëmbëzuar brenda kësaj periudhe me presion të fortë. Kushtet klimatike të pafavorshme (temperaturë e lartë, lagështi e ulët, erë, etj.) mund ta zvogëlojnë këtë kohë. Nëse kalon kjo periudhë, duhet të hiqni llaçin.

### Konsumi

Konsumi është 1-3 kg/m<sup>2</sup>, varësisht nga sipërfaqja.

### Karakteristika



THIS TECHNICAL DATA SHEET SUPERSEDES ALL PREVIOUS EDITIONS RELEVANT TO THIS PRODUCT

## Të dhëna teknike (NE +23°C DHE 50% U.R.)

Forma	Pluhur
Ngjyra	Gri/E bardhë
Magazinimi	12 muaj nëse ruhet në paketimin origjinal të mbyllur, në një vend të thatë
Raporti I përzjerjes	6-6.5 litra ujë / 15 kg pluhur
Temperatura e aplikimit	(+5°C) - (+35°C)
Trashësia e aplikimit	Deri në 10mm
Koha e punueshmërisë	6 Orë
Rrëshqitshmëria (EN 12004-2)	≤0.5mm
Koha e hapjes (EN 12004-2)	Pas 30 minutash ≥ 0.5 N/mm <sup>2</sup>
Forca e ngjitjes (EN 12004-2)	
- Fillestare	≥ 1 N/mm <sup>2</sup>
- Pas ekspozimit ndaj nxehtësisë	≥ 1 N/mm <sup>2</sup>
- Pas zhytjes në ujë	≥ 1 N/mm <sup>2</sup>
- Pas cikleve të ngrirjes/shkrirjes	≥ 1 N/mm <sup>2</sup>
Deformueshmëria (EN 12002)	≥ 5mm – S2 Shumë e deformueshme
Shkalla e temperaturës	(-40°C) - (+80°C)
Reagimi ndaj zjarrit	Bs1d0
Substanca të rrezikshme	Shiko SDS

### MATIS Construction Chemicals

Tiranë, Albania

info@matís-eu.com

www.matis-eu.com

T: +355 69 20 94 570

THIS TECHNICAL DATA SHEET SUPERSEDES ALL PREVIOUS EDITIONS RELEVANT TO THIS PRODUCT

2/2

DISCLAIMER: The above technical data, information, recommendations and guidance are based on scientific and technical knowledge, laboratory studies and long experience. However, the above information is considered to be as indicative and should be reviewed in any case in relation to each specific application conditions. Consequently, the suitability of each product in any application must be evaluated after referring to the updated Technical Data Sheet and to the website www.matis-eu.com, as well as after contacting the technical support department, in case of necessity. Our company guarantees the quality of the product itself, whilst in any case the user/applicant is exclusively responsible for any undesirable failures after using the product.